[Shqiptarja.com]

E mërkurë 19 Prill 2023 - Përditësimi i fundit 21:29

Kërko

LIVE [Shqiptarja.tv]

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

Flash Sondazhi 'Piepoli', transporti publik në Tiranë, 32% e qytetarëve e cilësojnë të keq

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Në kërkim për atentatin ndaj ish-prokurorit Arjan Ndoja e Rrumit të Shijakut, arrestohet në Fushë-Krujë Ramazan Rraja! Me vete i gjendet edhe pistoletë

2 Linda Rama: Të jesh shembull i virtytit s'është e lehtë, por përgjegjësi e vështirë dhe e rendë

3 Po e bënte gati për spektakël, grimieri ia thotë në sy Deas: E qeshura jote, si e vrasësve serial

4 Rama, Vuçiç e Kovaçevski bisedime në Itali për 'Open Balkan'! Kreu i qeverisë: Takimi i radhës mbahet në fund të majit! Tregtia mes 3 vendeve u rrit me 24.8%

5 Etapë e re në BBVIP, Luiz Ejlli thirrje teleshikuesve: Nëse ndodh kjo gjë sonte, do më ndryshojë jeta

Kronikë

Ekzekutohet duke pirë kafe në lokalin e tij biznesmeni në Shëngjin, anëtar i PSD për Këshillin Bashkiak Lezhë! FOTO nga momenti i vrasjes! Ja pistat e hetimit

*Biznesmeni **Ardian Nikulaj** ka mbetur i vrarë ditën e sotme në Shëngjin. Një person i maskuar me skafandër motori është futur dhe e ka qëlluar me armë brenda lokalit të tij. Nikulaj ishte kandidat i PSD për Këshillin Bashkiak në Lezhë për 14 majin. Ai ka qenë **kandidat për deputet në 2021** me po të njëjtën parti.*

- Ardian Nikulaj lëvizte me makinë të blinduar, i ruhej atentatit! Ja dy pistat e hetimit
- Nikulaj ishte vetëm në tavolinë në lokalin e tij, autori i maskuar me skafandër motori! E ndihmoi një tjetër dhe u larguan me 'Range Roverin' me targa angleze
- Del FOTO, ky është biznesmeni Ardian Nikulaj që u vra sot në Shëngjin
- U vra sot në Shëngjin, 51 vjeçari i dënuar në 2003-shin! 2 vite më parë kandidoi për deputet nën siglën e PSD

Redaksia
19 Prill, 13:40 | **Përditesimi: 19 Prill, 19:02**

SHËNGJIN- Biznesmeni dhe eksponenti politik, Ardian Nikulaj u ekzekutua mesditën e së mërkurës në bar-restorantin e tij në vijën e parë të plazhit të Shëngjinit. Siç shihet në këtë foto të siguruar nga Report Tv, atentatori ka hyrë i kamufluar me skafander motori, maskë covid dhe një jelek fostorishent, i ngjashëm me ato të policisë rrugore. Ka qëndruar përballë 50-vjecarit që konsumonte kafe dhe me një pistoletë TT ka qëlluar me 7 plumba, një prej të cilëve e ka kapur në ballë duke e lënë të vdekur në vend. Përballë në këmbë qëndron vjehrri i viktimës, i cili nuk ka marrë asnjë lëndim.

Duket se vrasësi ka qenë i përgatitur për të mos shkaktuar dëme në lokal, por të qëllojë vetëm mbi shënjestrën. Më pas është larguar me ndihmën e bashkëpunëtorit në krim për t'u arratisur nga vendngjarja me një 'Range Rover' të zi me targa angleze.

LEXO EDHE:
Vrasja e biznesmenit në Lezhë, Berisha: E vrau krimi qeveritar! Viktima ishte kundër kandidimit të Pjerin Ndreut e aleancës Rama-Doshi

Ardian Nikulaj që njihej dhe si Ardian Marku lëvizte me makinë të blinduar për shkak të hasmërisë së vjetër apo dhe konflikteve në biznes. Ai dispononte disa biznese, përfshirë bar-restorant "Coral"-in ku e ekzekutuan. Nikulaj në 2021 ishte kandidat për deputet nën siglën e Partisë Social-Demokrate me kryetar Tom Doshin. Prej 2019-ës ishte anëtar i Këshillit Bashkiak të Lezhës dhe rikandidonte sërish për në këshill në zgjedhjet e 14 Majit. Më herët ka mbajtur disa poste në administratën lokale si drejtor i OSHEE-së dhe ALUIZNIT.

Për të zbardhur ngjarjen, hetuesit janë përqendruar në dy pista; Hasmëria me fisin Palaj pasi në vitin 1999, Ardian Nikulajt i kanë vrarë vëllanë dhe disa vite më pas nga Palajt janë vrarë dy anëtarë të familjes.

Policia ka kryer kontrolle në 3 banesat e familjes Palaj në Lezhë, por askush nuk është gjetur sepse anëtarët e kësaj familje ndodhen jashtë vendit prej disa vitesh dhe ky fakt konfirmohet nga TIMS.

Raportoi për Report Tv dhe Shqiptarja.com gazetari Elvis Hila

Redaksia po punon për të mësuar më tepër detaje...



PSD-1536-LE

FORMULAR VETËDEKLARIMI

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"

DATË: 8 / 02 / 2021

I. TË DHËNAT PERSONALE

A. Gjenealitetet aktuale

EMËR	ARDIAN
MBIEMËR	NIKULAJ
ATËSI	LUIGJ
AMËSI	PRENE
DATËLINDJE	31.10.1972
VENDLINDJE	LEZHË
VENDBANIM	BALLDRE-LEZHË
NR. ID	H21031016O

B. Gjenealitete të mëparshme

(Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe aq herë sa janë ndryshuar. *Mosdeklarimi i ndonjë gjeneraliteti sipas kësaj pike, që mund të pengojë verifikimin sipas dispozitave të ligjit nr. 138/2015, përbën vepër penale sipas nenit 190 të Kodit Penal.*)

EMËR	ARDIAN
MBIEMËR	MARKU
ATËSI	LUIGJ

(Formulari i vetdeklarimit per zgjedhjet e 2021)



QKB

EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L68330501A
2. Data e Regjistrimit	30/09/2016
3. Emri i Subjektit	CORAL SHENGJINI
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	28/09/2016
6. Kohëzgjatja	Nga: 28/09/2016
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Lezhe Shengjin SHENGJIN Lagjja "Fran Ivanaj", Rruga e Plazhit, Ndertesa Nr.32, Kati 1, ne zonen kadastrale nr.3126.
8. Kapitali 8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1.000.000,00 2,00
9. Objekti i aktivitetit	- Ne fushen e ndertimeve civile dhe industriale, per vete dhe per te tjeret.- Ne fushen e grumbullimit, transportit dhe trajtimit te mbetjeve urbane.- Ne fushen e pastrimit te siperfaqeve urbane dhe jo urbane si dhe heqja e mbeturinave- Ne fushen e gjelberimit te siperfaqeve urbane.- Ne fushen e ngritjes se pikave te sherbimeve, Bar- Bufe, Restorant etj.- Ne fushen e sherbimeve Hoteliere dhe Turizmit, ne organizimin e tureve turistike.- Ne fushen e agjensi per shitblerje dhe dhenie me qera te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, agjensi turistike, agjensi komisionere etj.- Ne fushen e tregtise me shumice e pakice, import- eksport i tyre.- Ne fushen e peshkimit, zenien, ruajtjen, transportin dhe tregtimin e tij.- Ngritjen e dhomave frigoriferike per ruajtjen dhe konservimin e produkteve bujqesore e blektorale, si dhe cdo aktivitet te lejuar me ligj. -Parking automjetesh. Kamping Shezllone per pushuesit

Kopje nga web

(Ekstrakti i biznesit të Ardian Nikulaj)



Viktima Ardian Nikulaj

Rendit zhvillimet sipas orarit: Të Fundit

Ora 21:09

FOTO/ U ekzekutua sot në Shëngjin, Ardian Nikulaj pak muaj më parë kishte festuar 50-vjetorin me një darkë madhështore



Biznesmeni dhe politikani lokal në Lezhë Ardian Nikulaj, i cili u ekzekutua me armë zjarri mesditën e kësaj të mërkure në Shëngjin kishte festuar pak muaj me parë 50-vjetorin e lindjes. Në darkën e organizuar në lokalin në pronësi të tij ku dhe u vra në Shëngjin, Nikulaj kishte organizuar një darkë me shumë të ftuar.

Ora 17:40

Vrasja e Ardian Nikulaj në Shëngjin dyshohet për gjakmarrje! Policia kontrolle në 3 banesat e familjes Palaj



Lidhur me vrasjen e biznesmenit Ardian Nikulaj në Shëngjin, policia ka kryer kontrolle në 3 banesat e familjes Palaj në Lezhë. Ngjarja ndryshohet se lidhet me një konflikt të vjetër gjakmarrje të lindur në vitin 2000, ku anëtarë të familjes Palaj kanë ekzekutuar vëllain e Ardian Nikulaj. Pas kësaj vrasje në Lezhë janë ekzekutuar në një atentat dy anëtarë të familjes Palaj. Sot e kësaj dite kjo ngjarje e rëndë e ndodhur disa vite më parë është e pazbardhur dhe s'ka asnjë autor të dënuar nga drejtësia.

Por vetëm disa vite më pas vritet vëllai i dytë në familjen Nikulaj. Autori ka qëlluar plot 6 herë, pasi kjo vërtetohet në gjetjen e 6 gëzhojave në vendin e ngjarjes. Ndërsa viktima ka marrë vetëm një plumb në ballë. Autori rezulton të ketë përdorur një armë zjarri pistoletë tip TT. Viktima e ditës së ishte një figurë mjaft e njohur në Lezhë, i cili prej disa vitesh qëndronte dhe qarkullonte lirshëm në Lezhë dhe Shëngjin.

Ndërkohë në kuadër të hetimeve me qëllim zbardhjen e ngjarjes, policia ka shkuar në tre banesa të familjes Palaj në Lezhë. Nuk janë gjetur në banesë, asnjë prej familjarëve dhe djemve. Ata ndodhen jashtë shtetit dhe pretendimi i tyre është konfirmuar dhe nga TIMS, që tregon daljen e tyre jashtë shtetit disa vite më parë.

Ora 16:41

Vrasja e biznesmenit në Shëngjin, deputeti i PS: Të zbardhet një orë e më parë ngjarja



Deputeti i Partisë Socialiste, Eduart Ndreca ka tha se organet e ligjit duhet të zbardhin një orë e më parë vrasjen e Ardian Nikulajt.

> *"Ngjarja e rëndë e ndodhur sot, ku mbeti i vrarë Ardian Nikulaj, na ka tronditur shumë të gjithëve. Ardiani ishte një mik fort i mirë e i respektueshëm për të gjithë. Organet ligj zbatuese duhet të veprojnë me force, për ta zbardhur një ore e më parë këtë ngjarje të rendë. Ngushëllime familjes, gjithë miqve e shokëve. Të qoftë dheu i lehtë miku im. Shpirti të pushoftë në paqe", tha Ndreca.*

Ora 15:43

Vrasja e biznesmenit në Shëngjin, reagon Pjerin Ndreu: I tronditur!

Lajmi i fundit

Gjykata e Lartë e SHBA-së gati të vendosë për kufizimet e barnave të abortit

19 Prill, 21:28

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

Cenim i rëndë i rendite sigurisë

Kandidati për kryetar bashkie i Partisë Socialiste, njëkohësisht kryebashkiak i Lezhës, Pjerin Ndreu ka reaguar në lidhje me vrasjen e biznesmenit Ardian Nikulaj nga një person ende i paidentifikuar. Ndreu shkruan se ndihet i tronditur nga ngjarja dhe thotë se ky është një cenim i rendit dhe i sigurisë publike në qytetin tonë.

> *'I tronditur nga ngjarja e sotme ne Shengjin ku ngeli i vrare Ardian Nikulaj, biznesmen dhe anetar i keshillit bashkiak! Nje ngjarje e tille eshte cenim i rende i rendit dhe sigurise publike ne qytetin tone! Kerkoj me force nga organet e rendit dhe prokurorise qe te zbardhin sa me shpejt ngjarjen, per te vene perballe ligjit autoret e kesaj ngjarje te shemtuar! Shpreh ngushellimet e mia familjes se tij dhe te afermeve per kete humbje kaq tragjike!'- shkruan Ndreu.*

Ora 15:28

FOTO e vrasjes së biznesmenit në Shëngjin/ Autori me maskë COVID e me skafandër e qëllon me 7 plumba për vdekje brenda në lokal



Report Tv ka siguruar foton e vrasjes së Ardian Nikulaj mesditën e sotme në lokalin e tij në pedonalen e Shëngjinit. Autori shihet se është i maskuar me skafandër dhe jelek policie ndërsa qëllon në drejtim të tij, duke e lënë të vdekur në vend.

Ora 15:24

Atentat mafioz në Shëngjin, 2 autorët e kishin ruajtur prej kohësh dhe hynë mbrapa lokalit për ta ekzekutuar! E qëlluan 7 herë për vdekje

Detaje të reja janë zbuluar nga vrasja në Shëngjin këtë të mërkurë. Një autor ishte maskuar si motorist qëlloi 7 herë Ardian Nikulajn me armë zjarri duke e lënë të vdekur në vend.

Dy autorët kishin një plan të mirë përgatitur për atentatin ndaj 50-vjeçarit të linin e ruanin prej kohësh dhe kishin hyrë mbrapa lokalit në momentin që kishin konstatuar se nuk kishte njeri.

Ora 15:05

Vrasja në Shëngjin, Ardian Nikulaj lëvizte me makinë të blinduar, i ruhej atentatit! Ja dy pistat e hetimit

VENDNGJARJE MOS KALO
POLICIA
REPORT TV

Biznesmeni dhe eksponenti politik i cili u vra sot Ardian Nikulaj, lëvizte me makinë të blinduar dhe u ruhej atentateve. Nikulaj është ekzekutuar sot në lokalin e tij nga një person i maskuar. Dy pistat e hetimit për vrasjen e tij janë konfliktet në biznes dhe e shkuara e tij

Ora 14:32

Vrasja në Shëngjin, Nikulaj ishte vetëm në tavolinë në lokalin e tij, autori i maskuar me skafandër motori! E ndihmoi një tjetër dhe u larguan me 'Range Roverin' me targa angleze



Ardian Nikulaj i cili u vra në Shëngjin ishte vetëm në tavolinë në lokalin e tij 'Coral', kur autori i maskuar me skafandër motori e qëlloi për vdekje. Sipas burimeve të Report Tv, Nikulaj u vra në lokalin e tij, dy autorët u larguan me 'Range Rover' të Zi me targa angleze

Ora 14:15

VIDEO/ Vrasja në Shëngjin, në vendngjarje edhe kryetari i Bashkisë Lezhë

Kryebashkiaku i Lezhës, Pjerin Ndreu është paraqitur në vendngjarje pas vrasjes së biznesmenit Ardian Nikulaj pak minuta më parë.



Ora 14:08

VIDEO/U vra sot në Shëngjin, ja lokali ku biznesmeni 51-vjeçar u qëllua nga dy persona

Ardian Nikulaj është ekzekutuar ditën e sotme në lokalin e tij pranë portit në Shëngjin. Ai u vra në lokalin e tij nga dy persona.

Ora 13:56

U vra sot në Shëngjin, 51 vjeçari i dënuar në 2003-shin! 2 vite më parë kandidoi për deputet, rezulton kandidat për këshilltar bashkiak

[Shqiptarja.com]
POLICIA

Detaje të reja janë zbardhur rreth të kaluarës së Arian Nikulajt, 51 vjeçarit që u vra ditën e sotme në një lokal të Shëngjinit. Në vitin 2021, ai kishte kandiduar për postin e deputetit nën partinë e PSD-së, ndërsa gjithashtu rezulton kandidat në listën për këshillitarë bashkiakë aktualisht.

Në vitin 2003, Nikulaj rezulton i dënuar me 4 muaj burg për armëmbajtje pa leje. Ndërsa në 2006-ën është dënuar me gjobë për kontrabandë dhe falsifikim.



PSD-1536-LE

FORMULAR VETËDEKLARIMI

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 138/2015 "PËR GARANTIMIN E INTEGRITETIT TË PERSONAVE QË ZGJIDHEN, EMËROHEN OSE USHTROJNË FUNKSIONE PUBLIKE"

DATË: 8 / 02 / 2021

I. TË DHËNAT PERSONALE

A. Gjenealitetet aktuale

EMËR	ARDIAN
MBIEMËR	NIKULAJ
ATËSI	LUIGJ
AMËSI	PRENE
DATËLINDJE	31.10.1972
VENDLINDJE	LEZHË
VENDBANIM	BALLDRE-LEZHË
NR. ID	H21031016O

B. Gjenealitete të mëparshme

(Nëse keni ndryshuar zyrtarisht ndonjë nga të dhënat e gjeneralitetit tuaj, apo keni përdorur një gjeneralitet tjetër, qoftë edhe pa e ndryshuar zyrtarisht, listoni secilin prej tyre, duke plotësuar të gjitha të dhënat që janë ndryshuar dhe aq herë sa janë ndryshuar. *Mosdeklarimi i ndonjë gjeneraliteti sipas kësaj pike, që mund të pengojë verifikimin sipas dispozitave të ligjit nr. 138/2015, përbën vepër penale sipas nenit 190 të Kodit Penal.*)

EMËR	ARDIAN
MBIEMËR	MARKU
ATËSI	LUIGJ

(Kliko këtu për të lexuar dokumentin e plotë)

Ora 13:50

Del FOTO, ky është biznesmeni Ardian Nikulaj që u vra sot në Shëngjin



Gazetari i Report Tv, Sokol Dema ka siguruar foton e viktimës, Ardian Nikulaj. Nikulaj mbeti i vrarë në një lokal pranë portit në Shëngjin.

G.MO/B.K./Shqiptarja.com

TAG: Vritet Ardian Nikulaj | vrasje | Lezhe | Shengjin | ardian nikulaj

Komento

Komente

Vlora: 19/04/2023 19:59

Pse shkoj pjerin ndreu ne vendngjarje?

Përgjigju

Ben: 19/04/2023 19:27

E more ben noka shum njerz po i pret nbes..kshu ka me te ardh dita edhe ty...

Përgjigju

Dhdhdb: 19/04/2023 19:00

I kam fajin partit qe i marrin ne qaf njerzit. Fushat e madhe ne shqipwri se do zgjedhin njerzit te ndritur

Përgjigju

Toni: 19/04/2023 18:43

Pjerini ne vendngjarje pa sens… e para prish vendngjarjen e dyta devijon hetimet …. Po do zoti kryetar ik ne varrim ske pune aty apo e ndrite kur ishe ne polici .

Përgjigju

Gazetari: 19/04/2023 18:20

Perpara Pjerin perpara, kurre me mbrapa.

Përgjigju

Peshktari i Shkodres: 19/04/2023 17:37

Ka dal kundra PS kyt radhe dhe duket se beseprem Ndreu me Nokajt e Bajrat jane mbas kesaj.

Përgjigju

Arben: 19/04/2023 17:36

Keto vrasje tregojne se sa shume nevoje ka Shqiperia qe PS te kete pushtet absolut dhe dore te lire ne luften kunder krimit. Opozita krijon klime kaosi, trazira prandaj pavaresisht kush eshte vrasesi dhe motivi, keto ngjarje ndodhin per faj te opozites! Sepse opozita dobeson imunitetin e vendit me veprimtarine e vet destruktive!

Përgjigju

> **Faiku:** 19/04/2023 19:41
>
> Ke te drejt shoku Arben. Rroft partia Socialiste me shokun Edi. Rroft pluralizmi politik . Posht Sali Berisha dhe gjith klasa borgjeze me Ilir floririn. ✊

Keno: 19/04/2023 17:18

Te gjithe bisnesmen. Cfare beni keshtu se po na mbarojn bisnesmenet.

Përgjigju

Alb: 19/04/2023 17:02

Shqipnin e kan kap injoraten dhe krimi, per ta ska siguri. Lavdi komunizmite

Përgjigju

Genti: 19/04/2023 17:01

Sa harxhojne para per autoblinda te kishte paguar per roje dhe badigarde. Kjo do jet bere ne bshkeounim me te brendshem. Shengjini esht problematik se edhe makina qe u perdor per sulmin ne Top Çanel. ne Shengjin ishte vjedhur.

Përgjigju

Pallmall: 19/04/2023 16:59

Perpara kurre mbrapa...

Përgjigju

Lulimiri: 19/04/2023 16:49

Bandat e Tom Doshit e Pjerin Ndreut që policia i lë të lirë. Vend mafioz i ndyrë.

Përgjigju

> **Treshi:** 19/04/2023 17:22
>
> Pse nokajt. Jan hasmeri me nokajt Ito. Po shof komente qe thojn qe as nokat ska guxu me kto nikulajt. E ndersa ti po thu qe nokajt guxonkan.

> **Shninaku:** 19/04/2023 17:12
>
> Toma nuk ka shans me e ba se e ka pase shok dhe e din se Gjergj Nikulaj i ban edhe nja 20 vite tjera burg dhe pa e marre gjakun se len. Ndreu asht cub Mirdite dhe ska as bese as burrni po e ka prapanicen mrapa. Nokajt dyshohen

goni: 19/04/2023 16:45

Reagon Pjerin Ndreu?? Ai dihet dhe njihet si shok me biznesmenë dhe pastaj ekzekuton. Është puro mafioz dhe i pabesë!

Përgjigju

Polici: 19/04/2023 16:44

O pjerdhin , drejtorin e policise Vebin vete e vune shefat ke deshe i hoqe , i vune , mbeshtetjen e rames e ke …. Pse nuk e zbulon ngjarjen edhe kryetar edhe polic vet je .

Përgjigju

Vincens Tuku: 19/04/2023 16:23

Ardjani ka hy me pajtu Leksin e druve me Ben Ndoken. Vete Leksi ka pas nerhy me pajtu Hakat e F krujes me Nokajt se i kane vra Sandrin. Ene Bardhok Pllanaj ka pas nerhy me i pajtu. Shume armiq kta Nokajt se pajtusi nuk preket me dore

Përgjigju

lezha: 19/04/2023 15:54

ka mundesi qe vellai i keti me mbiemer marku ka vra dy vete mbase dhe me shume! ka qene nje me floke te gjata bisht ka ne burg nja 25 vjet shume trim por shume i nxehte nqs sgaboj! pjerino shoku vajdinit duhet te ishte ne burg per tentative vrasje ndaj petrit lleshit i dha pistoleten e shtetit vajdin lames qe i gjujti, pastaj tha ishte bashkpuntor i policise edhe pse kishte nja 5 vite qe ishte largu! nejse duhet jesh nje cik i prape te meresh me krimin ndryshe sja del dot

Përgjigju

> **@Tiku:** 19/04/2023 19:52
>
> @Tiku: Ka të drejtë lezha! Përveç asaj duhet t'a dijë edhe ngjarjen në 1996 në Lezhë kur zgjedhjet i vodhi PD-ja dhe Pjerini atëherë shef komisariati qëllonte me automatik në ajër tek sheshi i bibliotekës duke ndërruar krehrat njëri pas tjetrit! Lezha duhet t'a njohin edhe një lezhjan me mustaqe që gëzhojat e dala nga automatiku e gjakosen në mollzën e majtë, shenjë qe e mbajti deri sa vdiq!

> **Tiku:** 19/04/2023 18:08
>
> Asigjo su mor vesh ca ke dash me thone me lale

Nosku: 19/04/2023 15:50

I lumte dora...kishte arrdhe ora.shume ka zgjate.

Përgjigju

Gani: 19/04/2023 15:33

Sa gjynah ai personi ibtrete qe eshte trembur nga ngjarja.

Përgjigju

RrethRrotullimi: 19/04/2023 15:32

Rrumbullakut i ka ngele shkopi ne dore se brusha iku per lesh. Shume po vriten o Rrumbullak apo pret qe rama ta zbardhe kete vrasje. Merr grupin çiftelia dhe zbardhe o ramush se po te vriten shoket nje e nga nje.

Përgjigju

Shengjin 1: 19/04/2023 15:01

Kto zgjedhje kishte dal hapur kundra mazhorances mbeshteste opoziten

Përgjigju

po ky: 19/04/2023 14:59

Po ku l.qja kryetar bashkie apo kryetar komunale eshte qe shkon ne vendngjarje....pjerini ne vendngjarje me floket e xhelatiusura deri ne kuriz. O zot na ruaj viti 2023 o shqiptare o gomere a shikoni se cilet kemi perpara apo jo ?! a dilet o zot o perendi e votohet per kete shpurre te poshter e te ndyre politike majtas e djathtas nga te doni ju te votohet?!

Përgjigju

per O beni: 19/04/2023 14:32

Po ky ka qene nje nga me te fortet e Lezhes, as Nokajt skan guxu me i ba gja. Ka levize me mijera vota ne cdo zgjedhje. Beni e ka emnrin vllau dhe jane ne gjak me njerez ne fshat te vet nga vitet 90.

Përgjigju

e drejta: 19/04/2023 14:20

FILLUAN KRIMINELET E BERISHA/METAJ....

Përgjigju

Halir: 19/04/2023 14:19

Gjergj luca e mbante pas vetes, toma pas vetes, tashti e ka pas vete ky. Kte vit ja vlen te beah pushime ne shengjin deti eshte me i paster.

Përgjigju

Lali: 19/04/2023 14:13

Vrasesit duhet te kapen , shengjini aq esht nuk kan nga ikun

Përgjigju

Blindi: 19/04/2023 14:10

E shef qe sben pune makina blinduar, kur ske tru gjynaf.. Ashtu si dilte ky shume gjate ka shku, se sta fal hasmi, Ik restorante e kafe e qytete sipas deshires, Nderkohe me vrasje ne kurriz !!!

Përgjigju

Zani i Somes: 19/04/2023 14:08

Another “legend” gone! Lali Eri e njeh tet’ate?!

Përgjigju

Ops: 19/04/2023 14:07

Shoket e rames …

Përgjigju

Tom Kodoshi: 19/04/2023 14:02

Ku jane Tom Doshi e Pellumb Gjoka ka vrasje, derisa tu hahet edhe atyre koka plot tul

Përgjigju

> **Blerim:** 19/04/2023 16:18
>
> qa lidhje ka i dyti si je permend

Beni Ecen Vete: 19/04/2023 14:00

Te rrofshin pallatet e dry grate. Tash do nisin te marrin edhe hasmit gjakun e viteve 90

Përgjigju

> **Ermal:** 19/04/2023 15:13
>
> O beni/kurreshtari, e more dhe sot ushqimin gratis nga rrjeti? Vec per ty hyj e lexoj keto komentet kur vritet ndonje me emer, se i ke keto pyetjet fikse "a ishte ky i forte, a komandojne keta ketu apo aty?". Kam pershtypjen do jesh nga Berati, ose ndonje nga keto rrethet perqark tij, pa shkuar deri ne Vlore. Kur do e nxjerresh librin tend me vrasjet e ketyre "te forteve" qe kane shkuar para kohe ne boten tjeter? :)

> **O beni:** 19/04/2023 14:09
>
> O beni ky ka qene i forti I lezhes? Kto komandojn ne lezhe? Jane ne hasmeri fisi ktyre ?

Shkodra: 19/04/2023 13:51

Të fala shokëve se shumë e ke zgjat!!

Përgjigju

> **tony:** 19/04/2023 15:39
>
> nje me pak,kot ste vret njeri,TT dhe AK45 mos ndaloft per kedo qe ka ber keq njeriu

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Kushtetuesja cilëson të ligjshëm Bordin e karburanteve, si e vlerësoni?

☐ Të drejtë ☐ Të gabuar ☐ Nuk e di

Lajme të tjera

Ungrej i Lezhës, fshati që s’ka rrugë për në varreza! Banorët: Me arkivol në krah ecim një orë në këmbë

19 Prill, 18:05

U vra sot në Shëngjin, 51 vjeçari i dënuar në 2003-shin! 2 vite më parë kandidoi për deputet, rezulton kandidat për këshilltar bashkiak

19 Prill, 13:56

VIKTIMA
AUTORI

Vrasja e agjentit imobilar italian një vit më parë, dënohet me 12 vite burg muratori shqiptar

17 Prill, 21:24



Banorët e fshatit Kaçinar kundër HEC-eve në Mirditë, u rikthehen protestave: Edhe në kohën e Enverit s’na kanë lënë pa ujë

Elvis Hila

16 Prill, 13:51



PD hap fushatën elektorale në Lezhë, Bardhi: Rithemelimi po fuqizon Metën që solli në pushtet Ramën në vitin 2013! Në këtë betejë të pazakontë jemi për të ruajtur dinjitetin

16 Prill, 09:45

Aksident në Lezhë, ambulanca përplaset me 'Ford-in'! Shoferi i makinës përfundon me urgjencë në spital

16 Prill, 07:17



Prag sezoni, në Shëngjin mungojnë punëtorët! Palokaj: 20 mijë vende pune në hoteleri-turizëm

Elvis Hila

15 Prill, 17:20

Bie nga skela teksa po punonte, ndërron jetë punëtori në Shëngjin! Shoqërohet administratori i firmës

15 Prill, 08:30

Shëngjin/ Erozioni ‘gllabëron’ bregdetin e Kune-Vainit! Eksperti: Situatë alarmante, rrezikohet infrastruktura

Elvis Hila

14 Prill, 17:31

Rama nga Lezha: Berisha premton çudira që s’i bëri as kur nuk kishte damkën ‘Non Grata! Kandidati i tyre, njeri pa pin

13 Prill, 17:31

Zgjedhjet vendore të 14 majit, Alibeaj mbetet vetëm me 14 kandidatë për kryebashkiakë! Tërhiqen nga gara kandidatët e Mirditës dhe Gjirokastrës

12 Prill, 16:19

Tjetërsim të pronave në Lezhë, dërgohet për gjykim dosja ndaj ish-kryebashkiakut të Lezhës Fran Frroku si dhe 10 zyrtarë të tjerë

Keti Banushi

12 Prill, 09:48

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje